

Fletë Faktesh

Ankesa nën Aktin e Diskriminimit Racial

Çfarë është Akti i Diskriminimit Racial?

Akti i Diskriminimit Racial 1975 (Cth) (RDA-ja : Racial Discrimination Act) e bën të jashtëligjshme trajtimi i juaj në mënyrë të pakundër ligjit të të trajtojë padrejtësisht për shkak të racës, ngjyrës, prejardhjes, origjinës kombëtare ose etnike ose statusit të imigracionit.

Gjithashtu e bën urrejtjen raciale të kundraligjshme.

Kur mund të përdoret ky ligj?

Mund ta përdorni RDA-n për të siguruar një trajtim të drejtë në shumë fusha të jetës publike.

- **Punësimi** – marrja e një pune, termat dhe kushtet e një pune, trajnimi, promovimi, pushimi nga puna.
- **Arsimi** – regjistrimi ose studimi në një shkollë publike apo private, kolegji apo universitet
- **Strehimi** – marrja me qira apo blerja e një shtëpie apo uniti.
- **Marrja apo përdorimi i shërbimeve** – si bankave ose sigurimi, shërbime të ofruara nga departamentet qeveritare, shërbimet e transportit ose telekomunikacionit, shërbime profesionale si ato të ofruara nga avokatë, mjekë ose tregtarë, nga restorante, dyqane ose njësi argëtuese.
- **Qasja (aksesi) në hapësirat publike**- si parqe, zyra qeveritare, restorante, hotele ose qendra tregtare.

Çfarë është diskriminimi racor?

Diskriminimi racor ndodh kur një person trajtohet më pak i favorshëm se një person tjetër në një situatë të ngjashme për shkak të racës, ngjyrës, prejardhjes, origjinës kombëtare ose etnike ose statusit të emigrantit. për shembull, duhet të jetë diskriminim i drejtpërdrejtë një agjent i pasurive të patundshme rrefuzon të marrë me qira një shtëpi për një person, sepse ato janë të një prejardhje të veçantë racor ose ngjyrës së lëkurës.

Diskriminimi racor ndodh gjithashtu kur ekziston një rregull ose politikë që është e nejtë për të gjithë, por ka një efekt të padrejtë te njerëzit e një race të veçantë ngjyre, prejardhje, origjinë kombëtar ose etnik, apo statusi i emigrantit. Për shembull mund të jetë diskriminim indirekt nëse një kompani thotë që punonjësit nuk duhet të mbajnë kapuç apo gjëra të tjera

për kokën gjatë punës, sepse kjo gjë mund të ketë një efekt të padrejhtë për njerëz të disa racave apo etnive të ndryshëm.

Çfarë është urrejtja racore?

Është e kundraligjshme të bësh diçka në public, bazuar në racën, ngjyrën, origjinën kombëtare apo etnike, të një personi apo grup personash, e cila ka të ngjarë që të **ofendoni, fyeni, poshtëroni apo të frikësoni**.

Shembuj të urrejtjes racore mund të përfshinë:

- materiale ofenduese racore në internet, përfshirë e-forume, blogje, rrjete sociale në internet dhe faqe për shpërndarjen e videove
- komente offensive ose imazhe në material të shtypura si gazeta, revista fletushka apo broshura
- fjalime offensive në një tubim
- komente abusive në vende publike, si anije, vendin e punës, park, ose në transport publik ose në shkollë
- komente abuzive në evente sportive nga lojtarët, spektatorët, trenerë ose zyrtarët

Kur është sjellja offensive bazuar në racë, jo kundra ligjit

RDA-ja synon në balancimin e së drejtës për komunikim të lirë (Liria e Fjalës) dhe të drejtën të jetosh lirë nga urrejtja racore. RDA-ja thekson që gjërat e mëposhtme nuk janë kundra ligjit nëse bëhen “**në mënyrë të arsyeshme dhe me besim të mirë.**”

- **një punë artistike apo performancë – p.sh. një dramë ku sjelljet racore, ofensie shprehen nga një karakter (actor.)**
- **një deklaratë, publikim, diskutim ose debat bërë me qëllime origjinale akademik ose shkencore**
- **bërja e një raporti të drejtë dhe të saktë për një çështje me interes publik – për shembull, - një raportil drejtë në një gazetë në lidhje me sjelljen fyese raciale**
- **duke bërë një koment, nëse komentit është shprehje e besimit të vërtetë të personit**

Çfarë mund të bëj nëse pësoj discriminim ose urrejtje racore?

Mund ta ngrini direkt me personin ose personat që janë të përfshirë.

Nëse nuk zgjidhet me kaq, ose nëse nuk ndjeheni të kënaqur duke e bërë këtë, mund të ankoheni Komisionit të Drejtave të Njeriut (Australian Human Rights Commission). Gjithashtu mund të keni një avokat, person mbrojtës ose sindikatë të ankohen për ju.

Nuk ju kushon asgjë ankesa drejtuar në Komisionit.

Ankesa e juaj duhet të jetë me shkrim. Komisioni ka formularë ankimi që mund ta plotësoni dhe mund ta dërgoni me postë ose faks, ose mund ta bëni kërkesën në internet në faqen tonë të internetit. Nëse nuk jeni në gjendje ta bëni ankesën me shkrim, ne mund t'ju ndihmojmë.

Që ankesa e juaj të jetë e vlefshme duhet të jetë e arsyeshme që ngjarjet për të cilat doni të ankoheni janë diskriminim i paligjshëm dhe ju duhet të jepni detaje të mjaftueshme në lidhje me pretendimet e vitit, përfshirë atë që ndodhi, kur dhe ku ndodhi dhe kush i përfshirë.

Një ankesë mund të bëhet në çdo gjuhë. Nëse keni nevojë për përkthyes, mund tua sigurojmë një.

Ku mund të gjejë informacione të tjera?

Detajet e kontaktit të Komisionit Australian për të Drejtat e Njeriut janë:

Telefoni

Shërbimi Kombëtar i Informacioneve: 1300 656 419 ose (02) 9284 9888

TTY: 1800 620 241 (telefonatë falas)

Faks: (02) 9284 9611

Posta

GPO Box 5218

Sydney NSW 2001

Nepërmjet internetit-

Email: infoservice@humanrights.gov.au

Faqe internetit: www.humanrights.gov.au

Mund të bëni ankesë në internet

www.humanrights.gov.au/complaints_information/online_form/index.html.

Nëse jeni shurdhër ose me dëgjim të dobësuar mund të kontaktoni me TTY në nr. 1800 620 241. Nëse keni nevojë për përkthyes Auslan, ne mund tua sigurojmë këtë

Nëse jeni i/e verbër ose keni një dëmtim të shikimit, ne mund të ofrojmë informacione në formate alternative sipas kërkesës

Pika atë tjera kontakti për ankesat e urrejtjes racore.

Nëse jeni të shqetësuar rreth tregimeve offensive të medias, transmetime ose përmbajtje në internet, ju mund të ankoheni pranë autoritetit Australian të Komunikimeve dhe Medias, Bordit të Standardeve të Reklamimit ose Këshillit të Shtypit Australian për tregime në gazeta. Ju gjithashtu mund të ankoheni te Redaktori ose Menaxheri i organizatës së medias.

Nëse ju jeni të shqetësuar për sjelljen offensive të komshinjëve, mund t'ju drejtoheni një Qendre të Drejtësisë Komunitetit (Community Justice Centre) për ndihmë në zgjedhjen e problemiit, ose Departamentit të Strehimit nëse jetoni në shtëpi të shtetit.

Nëse kërenoheni nga violence në familje ose ju kanë sulmuar në mënyrë violente, drejtoheni në polici.

Këshilla ligjore të përgjithshme

Nëse mendoni të bëni një ankesë, mund të merrni këshilla ligjore (avokat) ose kontaktoni sindikatën tuaj. Shërbimet ligjore të komunitetit mund të ofrojnë këshilla falas, rreth diskriminimit dhe ngacmime. Detajet e kontakteve për qendrat ligjore të komunitetit mund të gjenden në faqen e internetit: www.nacic.org.au/directory.

Përgjegjësia: informacioni në këtë fletë fakti është menduar vetëm si një udhëzues, Nuk është një zëvendësim i këshillave juridike.